



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë ABCOM SHPK nga shoqëria Vodafone Albania SHA.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi në lidhje me përfkrimin e drejtpërdrejtë të kontrollit nga Vodafone Albania SHA të ABCOM SHPK.

Në datë 25 tetor 2019, palët kanë nënshkruar “Marrëveshje për shitje dhe blerje” përmes së cilës Vodafone Albania SHA synon të zotërojë 100% të kapitalit të ABCOM SHPK, së bashku me të gjitha filialet e tij në Shqipëri.

Palët pjesëmarrëse:

**Pala blerëse:** Vodafone Albania SHA ( VFAL) është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: Krijimin dhe vënien në punë të sistemeve të radio telefonisë së lëvizshme celulare GSM dhe kërkimi, projektimi, krijimi dhe venia në punë e Sistemeve të telekomunikacionit, përfshirë rrjetet e internetit ("Sistemet"), etj. Kryerja e transferimeve ndërkombëtare (eksport dhe/ose riekport, import) të artikujve me përdorim të dyfishtë në funksion të kryerjes së aktivitetit kryesor të Shoqërisë.

VFAL është nën kontrollin fundor të Grupit Vodafone (“Vodafone Group”) shoqëria holding një grupi shoqërisë me aktivitet kryesor operimin e rrjeteve të telefonisë së lëvizshme dhe ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme, të tilla si shërbimi i telefonisë celulare, mesazheve dhe shërbimi i të dhënave.

**Pala shitëse:** American Broadband B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Holandë,.

**Shoqëria Target:** ABCOM SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar me objekt veprimtarie: Të ideojë, zbatojë dhe të menaxhojë rrjete të telekomunikacionit dhe transmetimit të të dhënave dhe interkoneksionet në përgjithësi, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda shtatë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**